




Albanian version



Udhëzimet e DG NEAR për mbështetjen e BE për shoqërinë civile në rajonin e zgjerimit 2021-2027

Prodhuar nga DG NEAR me mbështetjen e TACSO 3
Skopje, June 2022

Përmbajtja

| | | |
|-----------------|--|----|
| | Përmbledhja | 2 |
| 1 | Shoqëria civile – një aktor themelor në axhendën e zgjerimit | 3 |
| 2 | Angazhimi i BE me shoqërinë civile– angazhimet kryesore të politikës së BE | 4 |
| 3 | Përkufizimi i shoqërisë civile | 6 |
| 4 | Mbështetja për shoqërinë civile nga BE nën IPA III | 7 |
| 5 | Bazat e objektivave specifike të Udhëzimeve dhe treguesit | 10 |
| 6 | Matja e rezultateve dhe ndikimit | 10 |
| Aneksi A | Kuadri i rezultateve | 11 |
| 1 | Ekziston një mjedis mundësues për shoqërinë civile për realizimin e aktiviteteve të saj. | 13 |
| 2 | Bashkëpunimi dhe partneriteti midis OSHC-ve dhe institucioneve publike është fuqizuar | 23 |
| 3 | Kapaciteti dhe qëndrueshmëria e OSHC-ve në realizimin e aktiviteteve të tyre në mënyrë efektive janë përforcuar. | 27 |



Versioni i parë i “Udhëzimeve për mbështetjen e shoqërisë civile në vendet e zgjerimit”, 2014-2020 u zhvilluan gjatë vitit 2013 nëpërmjet një procesi konsultativ që përfshiu palët kryesore të interesuara nga rajoni. Versioni i tanishëm i rishikuar është bazuar në mësimet e nxjerra dhe sugjerimet e përfaqësuesve të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC), institucioneve publike dhe palëve të tjera të interesuara në raste të ndryshme, sidomos në Forumin e Shoqërisë Civile të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, të organizuar në Shkup me 22-23 Janar 2020; konsultimet on-line të realizuara gjatë vitit 2020; dhe konsultimet në secilin vend përfitues të IPA në shkurt dhe mars 2021. Ky version i rishikuar gjithashtu merr në konsideratë gjetjet e vlerësimit të vitit 2017 të Programit të Shoqërisë Civile (Civil Society Facility) dhe gjetjet e Vlerësimit të Angazhimit të BE për Shoqërinë Civile në rajonet e zgjerimit, fqinjësisë dhe Ruisë 2007-2018. Vemendje e madhe i është kushtuar përcaktimit të treguesve të rezultateve të cilët mund të monitorohen objektivisht.



Këto Udhëzime janë për stafin e BE-së, shoqërinë civile në rajonin e zgjerimit dhe politikë-bërësit dhe zyrtarët e vendeve përfituese të IPA.

Prodhuar nga DG NEAR me mbështetjen e BE TACSO 3 për Forumin e Shoqërisë Civile të BE-së për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë
Shkup, qershor 2022

Drejtorja e Përgjithshme për Negociatat për Fqinjësi dhe Zgjerim (DG NEAR)



PERMBLEDHJE

Udhëzimet aktuale përcaktojnë rezultatet drejt të cilave aspiron mbështetja e BE-së për shoqërinë civile në rajonin e zgjerimit për periudhën 2021 – 2027. Ato janë zhvilluar për një audiencë të tre-fishtë:

- » Për stafin e BE-së: për të ndihmuar ato në dizenjimin dhe zbatimin e mbështetjes së BE-së për shoqërinë civile; dhe për të analizuar situatën e shoqërisë civile në vendet përfituese të IPA, përfshirë si pjesë e vlerësimit të progresit drejt kriterit politik të Kopenhagës.
- » Për shoqërinë civile në rajon: për të siguruar që ka një pikëpamje të përbashkët lidhur me rezultatet e pritshme të mbështetjes së BE-së për shoqërinë civile përsa i përket mjedisit mundësues; bashkëpunimin midis shoqërisë civile dhe autoriteteve publike; si dhe performancës dhe Standardet që vetë OSHC-të duhet të përmbushin.
- » Për politikë-bërësit dhe zyrtarët e vendeve përfituese të IPA: për t'i ndihmuar ato për zhvillimin dhe monitorimin e strategjive dhe mbështetjen e tyre për zhvillimin e shoqërisë civile, duke vendosur standarde dhe pritshmëri të rëndësishme – sidomos përsa i përket mjedisit mundësues për shoqërinë civile dhe përfshirjen e shoqërisë civile në politikë-bërje dhe procesin e integritimit në BE, dhe vecanërisht në lidhje me kategorinë e çeshtjeve themelore.

Mënyra se si secili vend përfitues i IPA i adreson këto çeshtje është një aspekt i rëndësishëm nën kriterin politik, përfshirë në kontekstin e negociatave të pranimit. Paketat e Zgjerimit të Komisionit raportojnë plotësisht mbi këto çeshtje nën kategorinë e çeshtjeve themelore, e cila është paraqitur me metodologjinë e rishikuar të zgjerimit të adoptuar në 2020.

Udhëzimet janë lidhur me një paketë solide të standarteve. Këto janë bazuar në Acquis të BE-së mbi shtetin ligjor (Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” dhe Kapitulli 24 “Drejtësia, liria dhe siguria”) dhe Standardet e tjera përkatëse ndërkombëtare dhe Evropiane. Më tej, ato janë në përputhje me rekomandimet, opinionet dhe udhëzimet e adoptuara nga organizatat ndërkombëtare dhe forumet ndër-qeveritare. Ato aplikojnë Standardet e zhvilluara nga shoqëria civile në nivel global.

Në vitet 2021-2027, mbështetja e BE-së për shoqërinë civile do të vazhdojë të përqëndrohet në fuqizimin e demokracive pjesëmarrëse dhe përafrimin me BE-në dhe procesin e integritimit në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi nëpërmjet forcimit të kontributit nga shoqëria civile. Mbështetja e BE-së do të synojë në arritjen e tre rezultateve të mëposhtme:

Një ambjent mundësues për shoqërinë civile për të realizuar aktivitetet e saj.

- » Një mjedis ligjor dhe politik mundësues për ushtrimin e të drejtave dhe lirive themelore, me fokus në lirinë e asociimit, grumbullimit dhe shprehjes.
- » Një mjedis financiar mundësues, i cili mbështet qëndrueshmërinë e OSHC-ve, me rregulla të duhura për financimin dhe taksat për shoqërinë civile.

Bashkëpunimi dhe partneriteti midis OSHC-ve dhe institucioneve publike është fuqizuar.

- » Institucionet publike të vendeve përfituese të IPA përfshijnë OSHC-të në procesin e vendim-marrjes dhe politikë-bërjes dhe mbikqyrjes dhe pranojnë rëndësinë e OSHC-ve në debatin politik të shoqërisë dhe proceset e integritimit në BE.
- » Institucionet publike të vendeve përfituese të IPA kontribuojnë në fuqizimin e shoqërisë civile duke bashkëpunuar me shoqërinë civile nëpërmjet formateve strategjike të politikave dhe mekanizmave përkatëse institucionale.

Kapaciteti dhe qëndrueshmëria e OSHC-ve për realizimin efektiv të aktivitetit të tyre është përforcuar.

- » OSHC-të janë të afta, transparente dhe të përgjegjshme.
- » Puna e OSHC-ve është e udhëhequr nga vizioni, strategjitë, dhe e bazuar në evidenca.
- » OSHC-të punojnë me burimet e duhura financiare dhe njerëzore.



1 — Shoqëria civile – një aktor themelor në axhendën e zgjerimit

Traktati mbi Bashkimin Evropian (Neni 49) përcakton se çdo shtet Evropian që respekton dhe është i angazhuar për promovimin e vlerave të përcaktuara në Nenin 2 të TBE, saktësisht respekti për dinjitetin njerëzor, lirinë, barazinë dhe shtetin ligjor dhe respekti për të drejtat e njeriut, përfshirë për të drejtat e personave që u përka-sin minoriteteve, mund të aplikojnë për tu bërë anëtar i Bashkimit. Një shoqëri civile e fuqizuar luan një rol të rëndësishëm për tu siguruar që këto parime janë zbatuar në praktikë dhe është një komponent kyç i çdo demokracie.

Rajoni i zgjerimit përballet me një sërë sfidash në lidhje me shtetin ligjor, përfshirë pavarësinë e gjyqësorit, luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, dhe lirinë e medias si dhe zhvillimin ekonomik, mbrojtjen e mjedisit, dhe kohezionin social. Shoqëria civile mund të bëjë një kontribut thelbësor për adresimin e këtyre nëpërmjet aktiviteteve të avokimit, monitorimit, novacionit, shërbimeve dhe mbikqyrjes. OSHC-të janë partner themelor për arritjen e ndryshimit shoqëror afat-gjatë dhe transformues.

Kur vjen fjala tek qeverisja demokratike, OSHC-të krijojnë kërkesën për më shumë transparencë, llogaridhënie dhe efektivitet nga institucionet përfituese të IPA dhe lehtësojnë fokusin mbi nevojat e qytetarëve. Ato gjithashtu kontribuojnë në proceset e integritetit rajonal dhe të pajtimit.

Përvec kësaj, përfshirja e shoqërisë civile në procesin e zgjerimit mund të kontribuojë në thellimin e kuptimit të qytetarëve për reformat e nevojshme për plotësimin e kërkesave për anëtarësim në BE. Kjo do të ndihmojë për tu siguruar që integrimi në BE është bazuar në pjesëmarrjen e vërtetë të qytetarëve dhe debatin publik.

Mënyra se si vendet përfituese të IPA adresojnë këto çështje është një aspekt i rëndësishëm i kriterit politik. Paketat e Zgjerimit të Komisionit në mënyrë të plotë raportojnë mbi këto çështje nën kategorinë e çështjeve themelore që është paraqitur në metodologjinë e rishikuar të zgjerimit të adoptuar në 2020.





2 Angazhimi i BE për shoqërinë civile – angazhimet kyçe të politikës së BE-së

Ne Komunikatën e vitit 2012 “Rrënjët e demokracisë dhe zhvillimi i qëndrueshëm: Angazhimi i Evropës me shoqërinë civile në marrëdhëniet e jashtme”², Komisioni Evropian përcaktoi parakushtet dhe prioritetet për mbështetjen e BE për organizatat e shoqërisë civile në kontekstin e marrëdhënieve të jashtme. Në mënyrë specifike për rajonin e zgjerimit, u zhvillua një instrument më i detajuar për mbështetjen dhe monitorimin e zhvillimit të shoqërisë civile—Udhëzimet për Mbështetjen e BE-së për Shoqërinë Civile në Vendet e Zgjerimit, 2014-2020³.

Pjesëmarrja e strukturuar e OSHC-ve në politikë-bërjen dhe vendim-marrjen është një prioritet kyç për BE. Komunikata “Rrënjët e demokracisë dhe zhvillimi i qëndrueshëm” tregon se legjislacioni, politikat dhe programet duhet të dizajnohen, zbatohen, monitorohen dhe vlerësohen në një mënyrë të hapur, transparente dhe përfshirëse dhe të integrojnë sic duhet arritjen dhe plotësimin e të drejtave të juriut.

Komunikata e vitit 2018 e Komisionit mbi një Perspektivë të Besueshme të Zgjerimit për dhe Angazhim të Përmirësuar me Ballkanin Perendimor⁴ gjithashtu kërkon një dialog të strukturuar me një shoqëri civile të fuqizuar dhe thekson nevojën për një mjedis mundësues për OSHC-të. Për më tepër, në Axhendën e Rregullores më të Mirë të brendshme të BE-së, Komisioni Evropian angazhohet të dëgjojë më me vëmendje qytetarët dhe palët e interesuara dhe të sigurojë që ato që ndikohen nga politikat kanë mundësinë të kontribuojnë për përmirësimin e tyre. Axhenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe Konsensusin e BE-së mbi Zhvillimin rithekson këtë angazhim, duke bërë thirrje për partneritete shumë-palëshe më të fuqishme dhe më përfshirëse.

Komunikata e 2020 mbi Çuarjen Përpara të Procesit të Anëtarësimit – një Perspektivë e Besueshme për në BE për Ballkanin Perendimor⁵ paraqiti një metodologji të re negociimi: kapitujt aktualë të negociimit tani grupohen

² COM(2012) 492 final of 12.9.2012: Rrënjët e demokracisë dhe zhvillimi i qëndrueshëm

³ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/guidelines-eu-support-civil-society-enlargement-countries-2014-2020_en

⁴ COM(2018) 65 final of 6.2.2018: Një perspektivë e besueshme zgjerimi për një angazhim të rritur të BE-së me Ballkanin Perendimor.

⁵ COM (2020) 57 final of 5.2.2020: Çuarja përpara e procesit të anëtarësimit – një perspektivë e besueshme e BE-së për Ballkanin Perendimor.





në 6 kategori tematike, përfshirë një mbi ato themelore, e cila përfshin gjyqësorin dhe të drejtat themelore, shtetin ligjor, institucionet demokratike dhe administratën publike. Shtylla kurrizore e kate-gorisë së çështjeve themelore është Acquis i BE-së për shtetin ligjor (Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” dhe Kapitulli 24 “Drejtesia, liria dhe siguria”) dhe Standardet e tjera përkatëse ndërkombëtare dhe Evropiane. Negociatat mbi çështjet themelore do të hapen të parat dhe do të mbyllen të fundit dhe do të përcaktojnë ritmin e përgjithshëm të negociatave. Kështu, këto çështje themelore do të bëhen edhe më qëndrore në negociatat e anëtarësimit.

Theksi i shtuar mbi çështjet themelore të anëtarësimit në BE është në përputhje me një fokus të rritur mbi forcimin dhe promovimin e vlerave bazë të BE-së brenda BE-së nëpërmjet një numri iniciativash të fundit të BE-së, përfshirë: Plani Evropian i Veprimit për Demokraci⁶; Mekanizmi i ri Evropian

për Shtetin Ligjor,⁷ dhe Strategjia e re Evropiane për Fuqizimin e Zbatimit të Kartës së të Drejtave Themelore⁸.

Në tetor 2020, Komisioni adoptoi Planin Ekonomik dhe të Investimeve për Ballkanin Perendimor⁹, me qëllim nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe social dhe rivitalizimin e rajonit. Për Planin, janë alokuar nga BE nga IPA III deri në €9 bilion grante dhe do të mobilizohen €20 bilion të tjera në investime. Plani do të investojë në projekte lider në fushat e transportit, energjisë, tranzicionit digjital dhe të gjelbër, sektorin privat dhe zhvillimin e burimeve njerëzore, për një zhvillim të qëndrueshëm dhe punësim. Plani gjithashtu mbështet integrimin rajonal ekonomik për të ndihmuar përsheptimin e konvergimit me BE, në fund të fundit, për-shpejtimin e procesit të integritimit në BE. Zbatimi duhet të shkojë krah për krah me reformat. Për-fshirja e gjërë e shoqërisë civile është çelësi për të ndihmuar në zbatimin e planit.

⁶ COM (2020) 790 final of 3.12.2020 mbi Planin Evropian të Veprimit për Demokraci (EDAP) synon të fuqizojë qëndrueshmërinë e demokracive të BE-së nëpërmjet masave për fuqizimin e lirisë së medias dhe pluralizmit; për të luftuar dizinformimin dhe për të siguruar zgjedhje të drejta dhe të lira.

⁷ Mekanizmi Evropian i Shtetit Ligjor ofron një proces për dialog vjetor midis Komisionit, Këshillit dhe Parlamentit, bashkë me shtetet anëtare si dhe parlamentet kombëtare, shoqërinë civile dhe palët e tjera të interesuara. Raportet BE-27 mbi Shtetin Ligjor që botohen në baza vjetore që nga 2020 janë bazat e këtij procesi.

⁸ COM (2020) 711 final of 2.12.2020: Strategjia për Fuqizimin e Zbatimit të Kartës së Lirive Themelore fokusohet në sigurimin e zbatimit efektiv të Kartës nga vendet anëtare dhe institucionet e BE-së dhe rritjen e ndërgjegjësimit të njerëzve për të drejtat e tyre nën këtë Kartë. Ajo njihet rolin kyç të organizatave të shoqërisë civile dhe mbrojtësve të drejtave të njeriut dhe thekson se ata duhet të jenë të aftë të punojnë pa frikë, në një mjedis mbështetës.

⁹ COM(2020) 641 final of 6.10.2020: Një Plan Ekonomik dhe Investimesh për Ballkanin Perendimor.



3 Përkufizimi i shoqërisë civile

Shoqëria civile është shumë heterogjene dhe përfshin një gamë të gjërë aktorësh dhe qëllimesh. BE konsideron që organizatat e shoqërisë civile përfshijnë një gamë të gjërë aktorësh me role dhe mandate të shumëllojshme, përfshirë të gjithë strukturat jo-qeveritare, jo-fitimprurëse, të pavarura, jo të dhunshme, nëpërmjet të cilave njerëzit organizohen për të arritur objektiva dhe ideale të përbashkëta, si politike, kulturore, fetare, mjedisore, sociale, apo ekonomike apo të lidhura me shëndetin [...] Ato përfshijnë, por nuk kufizohen, në: Organizatat jo-qeveritare, organizatat që përfaqësojnë njerëzit autoktonë, organizatat e grave dhe të rinjve, organizatat e diasporës, organizatat e migrantëve, shoqatat e tregëtarëve lokalë dhe grupet qytetare, kooperativat, shoqatat e punëdhënësve dhe sindikatat (partnerët social), organizatat që përfaqësojnë interesat ekonomike dhe sociale, organizatat që luftojnë korrupsionin dhe promovojnë qeverisjen e mirë, organizatat për të drejtat civile, organizatat që luftojnë diskriminimin, organizatat lokale (përfshirë rrjetet) të përfshira

në bashkëpunimin e decentralizuar dhe integrimin, organizatat e konsumatorëve, të mjedisit, arsimit, kulturës, kërkimit shkencor, universitetet, kishat dhe shoqatat dhe komunitetet fetare, organizatat filozofike dhe jo-fetare, mediat jo-fitimprurëse dhe çdo shoqatë dhe fondacion të pavarur jo-qeveritar, përfshirë fondacionet politike të pavarura¹⁰.

BE vlerëson diversitetin dhe specifikat e OSHC-ve dhe angazhohet me OSHC-të transparente, të përgjegjshme dhe të afta, që ndajnë angazhimin kundrejt progresit social dhe vlerave themelore të paqes, lirisë, të drejtave të barabarta dhe dinjitetit njerëzor.



BE vlerëson diversitetin dhe specifikat e OSHC-ve dhe angazhohet me OSHC-të transparente, të përgjegjshme dhe të afta.

¹⁰ Ky përkufizim i përgjithshëm është zhvilluar në Instrumentin për Fqinjësi, Zhvillim, dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Neighbourhood, Development and International Cooperation Instrument - NDICI) Programi Tematik për Organizatat e Shoqërisë Civile – Programi Shumë-vjeçar Tregues 2021-2027. Duhet nënvizuar se për thirrjet për propozime nën IPA III, kritere më specifike mund të aplikohen.



4 Mbështetja e BE-së për shoqërinë civile nën IPA III

Në 2008, Komisioni krijoi Programin e Shoqërisë Civile dhe Medias – CSF, një kuadër i plotë financiar për mbështetjen e shoqërisë civile dhe medias nën Instrumentin për Asistencë Para-Anëtarësimin – (IPA). Nën IPA II, BE programoi më shumë se € 330 milion nëpërmjet CSF-së.

BE është angazhuar që të vazhdojë të mbështesë shoqërinë civile nën kuadrin e ri financiar – 2021 – 2027. Rregullorja e IPA III tregon qartë mundësinë e mbështetjes për mjedisin mundësues dhe kapacitetin, pavarësinë dhe pluralizmin e shoqërisë civile. Kuadri programatik i IPA III¹¹ i referohet gjerësisht mbështetjes për shoqërinë civile, qoftë si mënyrë bashkëpunimi ndërsektorial ashtu edhe si një prioritet specifik.

Për periudhën 2021 – 2027, objektivi i përgjithshëm i CSF-së është të forcojë demokracinë pjesëmarrëse dhe procesin e përafrimit dhe integritit në BE në rajonin e zgjerimit nëpërmjet një kontributi të rritur të shoqërisë civile.

Tre rezultate kryesore do të mundësojnë shoqërinë civile që të jetë e aftë të luajë rolin e dedikuar në fushat tematike të veprimitarisë:

a)



Një ambjent mundësues për shoqërinë civile për të realizuar aktivitetet e saj.

b)



Bashkëpunim dhe partneritet i fuqizuar midis OSHC-ve dhe institucioneve publike.

c)



Kapaciteti dhe qëndrueshmëria e përforcuar e OSHC-ve për realizimin efektiv të aktivitetit të tyre.

Seksionet e mëposhtme japin një paraqitje të përgjithshme të këtyre tre rezultateve. Më shumë detaje jepen në Kuadrin e Rezultateve në Aneksin A.

¹¹ C(2021) 8914 final, Vendimi zbatues i Komisionit i 10.12.2021 që adopton Kuadrin Programatik për IPA III për periudhën 2021-2027. https://ec.europa.be/neighbourhood-enlargement/system/files/2022-01/C_2021_8914_COMMISSION_IMPLEMENTING_DECISION_EN.pdf



4.1 Një ambjent mundësues për shoqërinë civile për të realizuar aktivitete e saj

Një vend që dëshiron t'i bashkohet BE-së duhet të ketë krijuar dhe të zbatojë një mjedis të duhur ligjor, gjyqësor dhe administrativ për ushtrimin e lirive dhe të drejtave themelore, me fokus në lirinë e asociimit, grumbullimit dhe shprehjes. Kjo përfshin procedura regjistrimi transparente dhe jo-diskriminuese për OSHC-të, operim të lirë dhe të pavarur dhe bashkëpunim midis qytetarëve – formal ose informal – dhe mungesën e ndërhyrjes jo-pro-

porcionale dhe të pakërkuar të shtetit, përfshirë edhe në kuadrin e trajtimit të sfidave si terrorizmi, ekstremizmi, pastrimi i parave dhe korrupsioni. Një mjedis mundësues financiar duhet për të mbështetur qëndrueshmërinë e OSHC-ve dhe për të siguruar që OSHC-të janë financuar siç duhet për të ushtruar të drejtat e tyre në praktikë.

Në shumicën e vendeve anëtare të BE-së, legjislacioni

parashikon përfitime për OSHC-të që ushtrojnë aktivitete që konsiderohet të jetë në interesin publik. Kjo mund të arrihet nëpërmjet rregullave favorizuese për taksat për donacionet private, kuotat e anëtarësimit dhe filantropinë. Mbështetja direkte publike, financiare ose jo-financiare, duhet të jepet dhe raportohet në një mënyrë transparente, llogaridhënëse dhe jo-diskriminuese.

4.2 Bashkëpunim dhe partneritet i fuqizuar midis OSHC-ve dhe institucioneve publike

Pjesëmarrja e shoqërisë civile është një faktor kyç për qeverisjen e mirë dhe krijimin e zbatimit e legjislacionit dhe politikave që reflektojnë nevojat e njerëzve dhe që pranohen nga ata që preken. Gjithashtu, është e rëndësishme për reformat që përfituesit e IPA duhet të zbatoj-

jnë si pjesë e axhendës së tyre të integritetit. Strukturat dhe mekanizmat për bashkëpunim midis autoriteteve publike dhe OSHC-ve duhet të mundësojnë përfshirjen kuptim-plotë dhe konsultimin e vërtetë dhe konsiderimin e kontributit të OSHC-ve në procesin e vendim-marrjes.

Shpërndarja e lirë, qartë dhe e aksesueshme e informacionit mbi çështje të interesit publik është shumë e rëndësishme. Standardet minimale të konsultimit duhet të respektohen, përfshirë mekanizmat funksionale të marrjes së opinionit.

4.3 Kapaciteti dhe qëndrueshmëria e përforcuar e OSHC-ve për realizimin efektiv të aktivitetit të tyre

BE do të angazhohet me OSHC-të që janë të përkushtuara për forcimin e qëndrueshmërisë dhe kapacitetit të tyre për të punuar me sukses drejt misionit të tyre. Si aktorë të demokracisë pjesëmarrëse dhe progresit social, OSHC-të duhet gjithashtu të punojnë për përmirësimin dhe ruajtjen e pavarësisë së tyre, përfaqësimin, transparencës dhe llogaridhënies. Kjo përfshin, për shembull, forcimin e anëtarësisë dhe përqafimin e standardeve të larta të qeverisjes së brendshme.

BE do të mbështesë gjithashtu OSHC-të që përpiqen të rrisin efektivitetin e tyre në arritjen e rezultateve të qëndrueshme në mjedisin e tyre socio-politik (lokal, qendror, rajonal), dhe në fushat e tyre tematike të misionit. Kjo mund të përfshijë mbështetjen për të përmirësuar kapacitetin e tyre për analizë, monitorim dhe avokim, si dhe rrjetëzim, ndërtim koalicioni dhe përfshirje me evidencë në proceset e politikave dhe vendim-marrjes. Së fundi, qëndrueshmëria financiare kërkon zhvillimin

e anëtarësisë dhe përmirësimin e kapacitetit për diversifikimin e metodave për ngritjen e fondeve, duke targetuar burime publike dhe private për të gjeneruar të ardhura. Një kulturë e vërtetë e qytetarisë aktive kërkon pronësi lokale dhe burime të ndryshme dhe të qëndrueshme të financimit publik dhe privat.



4.4 Modalitetet e mbështetjes së BE-së

BE do të ofrojë një kombinim të mbështetjes për të arritur objektivat e paraqitura në këto Udhëzime. BE do të ofrojë mbështetje për përfituesit e IPA që të adoptojnë dhe zbatojnë një legjislacion që është më i favorshëm për shoqërinë civile, në mënyrë që të realizojë funksionet e saj. Në mënyrë të ngjashme, BE do të ofrojë mbështetje për institucionet publike që të përmirësojnë strategjitë e tyre për zhvillimin e shoqërisë civile dhe zbatimin e tyre. BE gjithashtu do të vazhdojë të promovojë përfshirjen e shoqërisë civile në proceset e para-anëtarësimit përfshirë në formulimin, zbatimin dhe monitorimin e strategjive sektoriale për asistencën financiare nga BE, e cila do të forcohet nën IPA III.

Asistenca financiare për OSHC-të do të vazhdojë të jepet nëpërmjet një përzierje të modaliteteve të financimit, në përgjigje të nevojave të tipeve të ndryshme të OSHC-ve, përfshirë qëndrueshmërinë. Bazuar në eksperiencën e IPA II, dhe në përputhje me rregullat financiare,

vëmendja do të vazhdojë të përqëndrohet në nevojën për angazhimin afat-gjatë dhe mbështetjen fleksibël për aktivitetet bazë; forcimin e partneriteteve dhe ndërtimeve të koalicionëve. Do të vazhdojë mbështetja për organizatat e vogla, sidomos nëpërmjet mbështetjes financiare për palët e treta dhe mekanizmave fleksibël të mbështetjes në përgjigje të nevojave të tyre specifike. Shoqëria civile do të mbështetet gjithashtu në kuadrin e programeve sektoriale, nëpërmjet masave që rrisin rolet dhe kapacitetin e tyre për të marrë pjesë aktive në formulimin dhe zbatimin e strategjive sektoriale për mbështetjen financiare të BE-së.

Mbështetja do të ofrohet nëpërmjet kanaleve biletarele dhe rajonale dhe do të synojë nivelet lokale, qendrore dhe rajonale. Rezultatet lidhur me projektet specifike janë paraqitur në Kuadrin e Rezultateve në Aneksin A dhe produktet, vlerat e synuara dhe aktivitetet do të adoptohen për secilin përfitues të IPA.

Fushat specifike tematike të mbështetjes do të përcaktohen gjatë programimit të rregullt dhe të detajuar dhe stadeve të kontraktimit dhe do të përfshijnë, midis të tjerave, fushat prioritare që burojnë nga Plani Ekonomik dhe Investimeve. Në përgjithësi, do të favorizohet pjesëmarrja e rritur e OSHC-ve në çështjet e kriterit politik (sidomos transparenca, shteti ligjor, lufta kundër korrupsionit, liria e shprehjes dhe medias, dhe lufta kundër diskriminimit), por gjithashtu edhe në reformat kyçe ekonomike dhe përafrimin me *acquis*, nga tranzicioni dualist i gjelbër-digjital tek kapitali njerëzor dhe çështjet sociale.



5 — Bazat e objektivave specifike të Udhëzimeve dhe treguesit

Objektivat specifike dhe treguesit e paraqitur në këto Udhëzime janë bazuar në një sërë standardesh solide rajonale dhe ndërkombëtare.

Për mjedisin mundësues dhe marrëdhëniet midis OSHC-ve dhe institucioneve publike, objektivat dhe treguesite përfshira në kuadrin e rezultateve janë bazuar në kuadrin ndërkombëtar dhe Evropian të drejtave të njeriut, përfshirë Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (ECHR), si dhe në Kartën e BE-së të të Drejtave Themelore, që është e detyrueshme për institucionet e Bashkimit dhe vendet anëtare kur ata aplikojnë legjislacionin e BE-së. Më tej, ato janë në përputhje me rekomandimet, opinionet, udhëzimet dhe kodet e sjelljes të adoptuara nga

Këshilli i Evropës, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE), Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), Kombet e Bashkuara, dhe forumet e tjera ndërkombëtare si dhe dokumentet e ngjashme të adoptuara nga BE.

Lidhur me qëndrueshmërinë dhe kapacitetin e shoqërisë civile, Udhëzimet frymëzohen në rradhë të parë nga Standardet Globale për Llogaridhënien e OSHC-ve (Global Standard for OSHC Accountability)¹² të zhvilluara nga shoqëria civile në nivel global.

Kuadri i Rezultateve në Aneksin A paraqet rezultatet e detajuara dhe treguesit e rezultateve të përzgjedhura për këto Udhëzime.



Objektivat specifike dhe treguesit e paraqitur në këto Udhëzime janë bazuar në një sërë standardesh solide rajonale dhe ndërkombëtare.

6 — Matja e rezultateve dhe ndikimit

DG NEAR do të monitorojë dhe vlerësojë mbështetjen e tij për shoqërinë civile në disa nivele. Ajo do të monitorojë dhe vlerësojë në nivel projekti dhe programi. Përtej kësaj, ajo do të analizojë zhvillimin e situatës lidhur me shoqërinë civile në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, përfshirë edhe si mjet për të identifikuar fushat kryesore për

vëmendje dhe mbështetje. Kjo do të bëhet nëpërmjet një ushtrimi të rregullt monitorimi, duke përdorur treguesit dhe burimet e të dhënave të paraqitura në këto Udhëzime dhe anekset e tyre. Të dhënat do të mblidhen nga një kombinim i kërkimit, anketave, intervistave dhe grupet e thelluara të fokusuara. Gjetjet do të validohen

me OSHC-të, autoritetet publike dhe palët e tjera të interesuara.

¹² <https://accountablenow.org/the-global-standard-for-cso-accountability/>



Aneksi A

Kuadri i Rezultateve



PERMBLEDHJE E OBJEKTIVAVE SPECIFIKE

OBJEKTIVAT SPECIFIKE



Një ambjent mundësues për shoqërinë civile për të realizuar aktivitete e saj.

OS 1.1. Të gjithë individët dhe subjektet juridike në rajonin e zgjerimit mund të krijojnë, bashkohen dhe marrin pjesë në organizata informale dhe/ose të regjistruara, mund të bashkohen paqësisht dhe shprehin veten lirisht.

OS 1.2. Autoritetet publike mbrojnë OSHC-të nga ndërhyrjet dhe sulmet dhe respektojnë të drejtën e tyre të privacisë.

OS 1.3. Masat e përdorura për të luftuar ekstremizimin, terrorizmin, pastrimin e parave apo korrupsionin janë të targetuara dhe proporcionale, në përputhje me qasjen e bazuar në rrezikun dhe respektojnë Standardet e të drejtave të njeriut lidhur me lirinë e asociimit, grumbullimit dhe shprehjes.

OS 1.4. Autoritetet publike trajtojnë në mënyrë të barabartë të gjitha OSHC-të lidhur me operacionet e tyre dhe si të barabarta me subjektet e tjera (si bizneset).

OS 1.5. Autoritetet publike qendrore dhe/ose lokale kanë politika dhe rregulla mundësuese për organizatat e vogla komunitare dhe inisiativat qytetare (organizatat grass-roots).

OS 1.6. Të gjitha OSHC-të janë të lira të kërkojnë dhe marrin fonde.

OS 1.7. Mbështetja publike financiare dhe jo-financiare për OSHC-ve në vendet përfituese të IPA ekziston dhe ofrohet në një mënyrë transparente, llogaridhënëse, të drejtë dhe jo-diskriminuese

OS 1.8. Individët dhe bizneset kanë përfitime në taksa për donacionet e tyre për OSHC-të.

OS 1.9. Përfitimet lidhur me taksat ekzistojnë për OSHC-të.

OS 1.10. Politikat dhe mjedisi ligjor nxit dhe lehtëson vullnetarizmin dhe punësimin në OSHC.



Bashkëpunim dhe partneritet i fuqizuar midis OSHC-ve dhe institucioneve publike

OS 2.1. Autoritetet dhe institucionet publike përfshijnë OSHC-ve në proceset vendim-marrëse dhe politikë-bërëse.

OS 2.2. Autoritetet dhe institucionet publike pranojnë rëndësinë e shoqërisë civile në debatin shoqëror mbi politikat dhe proceset e integritetit Evropian.

OS 2.3. Autoritetet publike kontribuojnë për fuqizimin e shoqërisë civile duke bashkëpunuar me shoqërinë civile nëpërmjet kuadrove strategjike të politikave dhe mekanizmave përkatëse institucional.



Kapaciteti dhe qëndrueshmëria e përforcuar e OSHC-ve për realizimin efektiv të aktivitetit të tyre

OS 3.1. Strukturat e qeverisjes së brendshme të OSHC-ve bazohen në parimet e qeverisjes së mirë.

OS 3.2. OSHC-të janë të afta të komunikojnë rezultatet e aktiviteteve të tyre tek publiku.

OS 3.3. OSHC-të janë transparente lidhur me aktivitetet programatike dhe burimet e financimit.

OS 3.4. OSHC-të monitorojnë dhe vlerësojnë rezultatet dhe ndikimin e punës së tyre.

OS 3.5. OSHC-të përdorin kërkimin dhe evidencat për të bazuar punën e tyre.

OS 3.6. OSHC-të punojnë në partneritete të drejta dhe të respektuara për arritjen e qëllimeve të përbashkëta.

OS 3.7. OSHC-të kanë një bazë financimi të diversifikuar.

OS 3.8. OSHC-të kanë burime njerëzore efektive, të fuqizuara dhe të zhvilluara.

Objektivi i përgjithshëm është të forcohen demokracitë pjesëmarrëse dhe procesi i përafrimit me BE-në në rajonin e zgjerimit nëpërmjet një kontributi të rritur të shoqërisë civile.



KUADRI I REZULTATEVE

OBJEKTIVI I PERGJITHSHËM/
NDIKIMI

Objektiva e përgjithshme është të forcohen demokracitë pjesëmarrëse dhe procesi i përafrimit me BE në rajonin e zgjerimit nëpërmjet një kontributi të rritur të shoqërisë civile.

OBJEKTIVI
SPECIFIK

1

Është krijuar një ambjent mundësues për shoqërinë civile për të realizuar aktivitetet e saj.

Objektivi Specifik

1.1

Të gjithë individët dhe subjektet juridike në rajonin e zgjerimit mund të krijojnë, bashkohen dhe marrin pjesë në organizata informale dhe/ose të regjistruara, mund të bashkohen paqësisht dhe shprehen lirisht

» Treguesi 1.1.a

Sa legjislacioni kombëtar respektiv mundëson që:

- » Shoqatat mund të krijohen dhe regjistrohen pa asnjë lloj disriminimi;
- » Nuk ka kufizime të paligjshme për aktivitetet e tyre ose ndjekjen e objektivave të tyre;
- » Shpërndarja e tyre mund të ndodhë pas vendimit të një gjykate të pavarur dhe të paanshme;
- » Nuk ka kufizime të paligjshme për lirinë e grumbullimit paqësor;
- » Lirija e shprehjes ushtrohet nga të gjithë dhe nuk ka kufizime të paligjshme.

» Standardet relevante të BE dhe të tjera

— Konventa Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut (ECHR) Neni 11 – liria e grumbullimit dhe asociimit, Neni 10 – liria e shprehjes
— Karta e BE-së e të Drejtave Themelore: Neni 12 – liria e grumbullimit dhe asociimit; Neni 11: liria e shprehjes
— OSCE/ODIHR-Udhëzimet e Komisionit të Venecias mbi

Lirinë e Asociimit, 2015
— ODIHR Udhëzimet për Mbrojtjen e Mbrojtësve të Drejtave të Njeriut
— Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec(2007)14 i Komitetit të Ministrave të vendeve anëtare mbi statusin ligjor të organizatave jo-qeveritare në Evropë, 10

tetor 2007, para 44.
— Këshilli i Evropës, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, 1950, Nenet 10 & 11.



Objektivi Specifik

1.2

Autoritetet publike mbrojnë OSHC-të nga ndërhyrjet dhe sulmet dhe respektojnë të drejtën e tyre të privacisë

» Treguesi 1.2.a

Sa OSHC-të kanë akses në një qasje efektive për të sfiduar ose kërkuar rishikim të vendimeve që ndikojnë në ushtrimin e të drejtave të tyre.

» Standardet relevante të BE dhe të tjera

— Acquis Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore
